



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:214986
Datë: 30.07.2024
Numri i dokumentit: 05998421

C.nr.1034/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Greta Ibraj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V. D. S., nga Prishtina, lagja E., B X, nr.xxx, kundër të paditurit L. D. nga Prishtina, me adresë Rr. “N. T., ”, p.n., me bazë juridike kthim i kundërvlerës së banesës së shitur, jashtë seancës gjyqësore, më datë 30.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditëses V. D. S., nga Prishtina, e evidentuar nën shenjën C.nr.1034/2017, e paraqitur më datë 21.08.2013, kundër të paditurit L. D. nga Prishtina, me adresë Rr. “N. T. ”, p.n., me bazë juridike kthim i kundërvlerës së banesës së shitur.

A r s y e t i m

Paditësja, V. D. S., më datë 21.08.2013, pranë kësaj Gjykate, ka paraqitur padi kundër të paditurit L. D. nga Prishtina, me adresë Rr. “N. T., ”, p.n., me bazë juridike kthim i kundërvlerës së banesës së shitur.

Gjykata, gjatë shqyrtimit të kësaj padie, gjeti se e njëjta nuk është përpiluar konform nenit 99 paragrafi 2 të LPK-së dhe rrjedhimisht e pamundëson veprimin e Gjykatës sipas saj. Kjo, për faktin se padia nuk përmban firmën e parashtrueses, si një nga kërkesat ligjore të përcaktuara nga neni 99 paragrafi 2 i LPK-së, për rregullsinë e parashtrësve.

Marrë parasysh këtë situatë, me qëllim të eliminimit të të metave që e pamundësojnë veprimin sipas padisë në fjalë, Gjykata ka nxjerrë aktvendimin C.nr.1034/2017, të datës 10.07.2024, me të cilin, paditëses i është kthyer në plotësim padia e datës 21.08.2013, që në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë të njëjtën duke e nënshkruar padinë e pa nënshkruar. Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi paditësja ka qenë e njoftuar për pasojat ligjore në rast të mos veprimit konform aktvendimit konkret.

Gjykata, ka tentuar që aktvendimin në fjalë, paditëses të ia dorëzojë në adresën e dhënë në padi, megjithatë komunikimi i atillë ka qenë i pa mundur të realizohet, ngase siç del nga fletë dërgesa për dorëzim personal e bashkëngjitur në shkresat e lëndës, adresa e siguruar nuk ka

qenë e mjaftueshme, çka shihet nga shënimi: “Pala e panjohur, adresa e pasaktë, të ceket hyrja dhe numri”.

Nisur nga një rrethanë e tillë, Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 116 të LPK-së, ka nxjerrë aktvendimin e datës 15.07.2024, duke vendosur që komunikimi i shkresave dhe parashtrësave për paditësen, të realizohet përmes afishimit në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate.

Gjykata, Aktvendimin C.nr.1034/2017 të datës 10.07.2024, ia ka dorëzuar paditëses përmes afishimit të të njëjtit në tabelën e shpalljeve të Gjykatës, më datë 15.07.2024. Konform dispozitës së nenit 116 paragrafi 6 të LPK-së, komunikimi është konsideruar i realizuar me kalimin e afatit prej 7 ditësh nga dita e afishimit të shkresës në tabelë.

Duke qenë se në rastin konkret, afati ligjor prej tre ditësh për korrigjimin/ plotësimin e padisë, ka kaluar pa veprimin e paditëses konform aktvendimit të lartcekur të datës 15.07.2024, Gjykata vlerësoi se në kuptim të nenit 102 paragrafi 3 të LPK-së, ku përcaktohet se “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”, padia në fjalë duhet të konsiderohet e tërhequr.

Padia e cila është konsideruar e tërhequr, konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në Gjykatë përsëri.

Nga të lartcekurat, Gjykata duke u bazuar në nenin 142 e lidhur me nenin 102 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1034/2017, më datë 30.07.2024

Gjyqtarja

Greta Ibraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për Gjykatën dhe palët.